




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02- (I)/22
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATE/A	30.09.2022
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL:

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së parë (I) e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 30.09.2022, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti Kryetarin e Komunës z. Ruzhdi Shehun, nënkryetarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit. Në mbledhje nga drejtorët prezent ishin: znj. Leunora Shehu-AD, znj. Vjollca Qestaj-DBF, znj. Gentiana Tofaj-DZHE, z. Zenun Shala-DUKM, z. Xhavit Velijaj, z. Fatos Shala-DSHMS, z. Demokrat Ganiqaj-DSHPMS.

Anëtarët prezent

1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK
2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK
3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK
4. Albertina Gacaferi - Anëtare, LDK
5. Ermelinda Llojuni - Anëtare, LDK
6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK
7. Leonard Llojuni - Anëtar, AAK
8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK
9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK
10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK
11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK
12. Festina Maloku - Anëtare, AAK
13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV
14. Eliza Pepshi-Anëtare, LVV
15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2023-2025,

z. Shpejtim Gacaferi, e hapi debatin rreth rendit të ditës.

z. Sadri Krasniqi, përshëndetje për të gjithë, në pajtohemi me rend të ditës.

z. Leonard Llojuni, përshëndetje për të gjithë, rendi i ditës është i njëjtë, mirëpo ne jemi kundër sepse dy kërkesat tona nuk janë përfshirë në këtë buxhet, ndërtimi i sheshit në qendër të Junikut dhe heqja e 20000€ për blerjen e veturës.

z. Lulzim Gacaferi përshëndetje për të gjithë në jemi për këtë rend të ditës, gjatë këtyre ditëve kemi patur në zyrë të kryetarit të komunës dhe kemi një marrëveshje ndaj grupit të LVV-se qendër Junik është për këtë rend të ditës.

z. Shpejtim Gacaferi, propozime tjera nuk, e qes në votim rendin e ditës, kush është për këtë rend të ditës? për 11 vota, 4 vota kundër, abstenim 0 vota, konstatoi se rendi i ditës miratohet.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2023-2025,

z. Sadri Krasniqi, sa i përket këtij projekt buxheti, unë mendoj se ky projekt ka qenë dashur të votohet para tri ditëve sepse projekti ndërtimi i sheshit qendra Junik vete ishte në këtë projekt buxhet ndaj i lus të gjitha asamblastët e këtij kuvendit që ta votojnë këtë buxhet sepse besimin e qytetarëve e kemi marrë për këtë dokument sepse ky është përfitimi i qytetarëve, dhe besoj se është mirë i projektuar, unë edhe një herë i ftoj të gjithë asamblastët e kuvendit ta votojnë këtë buxhet për hirë të qytetarëve,

z. Leonard Llojuni, sa i përket kësaj pike, projekti ndërtimi i sheshit qendra Junik në projekt buxhet parashihet për vitin 2024 dhe nuk i dihet fare burimi i financimit, ko është vetëm një mashtrim që të unë nuk shitet është mashtrim vetëm sa me e kaluar këtë projekt buxhet shikoni tabelat, nuk ka burim të financimit.

z. Lulzim Gacaferi, jemi duke e debatuar projekt buxhetin për vitin 2023-2025, ne kemi një marrëveshje mes LDK-LVV dhe në atë marrëveshje kemi parapare këtë projekt ndërtimin e sheshit qendra në Junik, ndaj ne duam që projekti të realizohet ashtu siç e kemi në marrëveshje në kuadër të kësaj në si LVV_ do ta votojmë buxhetin.

z. Zenel Maloku, përshëndetje për të gjithë, në si subjekt nuk kemi kërkuar stimulim, nuk kemi kërkuar për diçka për çështjet personale, por kemi kërkuar që të bëhet diçka e mirë në qendrën e Junikut, personalisht jam që qendra të ndërtohet sepse është pasqyrë e të gjithë neve.

z. Dervish Bajraktari, përshëndetje për te gjithë, sa i përket projekt buxhetit ne si AAK bashkë edhe me LVV para tri ditëve kemi qene kundër këtij projekt buxheti dhe kërkesat kanë qenë shume parimore dhe normale qe te niset projekti i ndërtimit te sheshit qendra e Junikut, qe ka qene edhe premtim nga ju së bashku me LVV-j, si dhe kemi patur kërkesë për mos ndarjen e 200000€ për blerjen e veturës dhe po e shohë se pas tri ditëve gjerat paskan ndryshuar, kërkesat tona nuk janë plotësuar ndërtimi i sheshit qendra e Junikut nuk po ndërtohet, blerja e veturës nuk po hiqet, dhe koleget qe deri dje ishin për këto kërkesa po shihet se nuk e kanë patur vetëm për kërkesat te qytetarëve, por për kërkesa personale.

z. Besart Tofaj, përshëndetje për te gjithë, unë e kërkoja fjalën qe te kërkojë nga asamblistët e kuvendit ta votojnë këtë buxhet, ta votojnë këtë buxhet sepse me te parashihen projekte qe është dashur qe para shume kohesh te kryhen, ne akoma kemi problem me ujin e pijes, me rrugë, me ndriçim, qe jenë me te rëndësishme se ndërtimi i qendrës, por edhe ky projekt do te realizohet kësaj i qëndron prapa, kryetari është betuar se do ka përfundoj dhe ne i besojmë kësaj, andaj kërkojë nga ju qe ta përkrahni këtë projekt buxhet.

z. Arten Hamza, përshëndetje për te gjithë, dihet se projeksionet buxhetore janë për tri vitet e ardhshme me theks te veçanet për vitin 2023 por janë edhe parashikimet për vitin 2024 dhe 2025, projekti për ndërtimin e sheshit është i paraparë ne vitin 2024 ne vlerë prej 200000€ dhe ne vitin 2022 45000€ burimi finansiare është Komuna e Junikut d.m.th këto 245000€ janë te siguruar nga komuna e Junikut, për projekte kapitale ne vitin 2023 është shuma 380000€ për vitin 2024 sipas qarkores buxhetore i kemi 4848841€ ndërsa për vitin 2025 559868€ qe janë te lejuar për kategorinë shpenzime kapitale.

z. Lulzim Gacaferi, faleminderit kryesues, u tha këtu se kemi bere pazare, AAK duhet ta dine se ne kemi një marrëveshje me LDK dhe ne kemi berë mirë qe kemi këtë marrëveshje, marrëveshje me te cilën i kemi larguar ata qe kane dëmtuar Junikun, por do ishte mire qe ti shikoni anëtarët e juaj qe do ta votojnë këtë buxhet sepse ne e votojmë me kënaqësi, sepse jemi për ndryshim sepse ndryshimi nuk behet ndryshe por duke punuar dhe duke i mbrojtur parimet e qytetarëve te Junikut.

z. Dervish Bajraktari, unë po i përgjigjem z.Lulzim Gacaferi, ne nuk i mbajmë anëtarët tanë me zor, ata janë te lirë dhe veprojnë sipas mendimit te tyre por i them se ku janë parimet e LVV_je.

z. Lulzim Gacaferi, Juniku është i joni dhe e kemi për obligim, moralisht, kombëtar, ligjore te punojmë për interesat e qytetarëve, ju e dini shumë mirë se unë personalisht asnjë cent nuk mar prej këtij vendi, i le punët e mija shumë keq vetëm qe ti shërbej këtij vendi dhe beje politik parimore, mbështes marrëveshjen qe e kemi me LDK dhe i qëndroj pas kësaj marrëveshje.

z. Ruzhdi Shehu, deshta ta sqaroj se ky buxhet nuk është as i Lulzimit, as i Leonardit por është ndërtuar ne baze te dëgjimeve publike qe kemi pasur ne si komune por edhe kuvendi por edhe KPF, drejtoresha e Financave, por edhe me shoqërinë civile për edhe prej kërkesave te qytetarëve qe i kane parashtruar, nuk ka te beje me as një premtim, sheshi është i nevojshëm te ndërtohet këtë e kemi paraparë se si do te ndërtohet dhe ne vitin 2023 nga te hyrat vetanake për qasjen e hartimit te projektit, ndërsa sa i për këtë veturës, te gjitha veturat qe posedojmë janë me defekte


te pa regjistruar andaj kemi nevojë që ta kemi një veturë që zyrtarët dhe drejtorët ta kenë mundësinë për nevojat e komunës të udhëtojnë në Prishtinë, këtë vit kemi buxhet me të rritur rritje kjo që është bërë nga të hyrat vetanake andaj unë kërkoj nga ju që ta votoni.

z. Shpejtim Gacaferi, propozime tjera nuk ka ftoj që të votojmë për projekt Buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2023-2025, kush është për? për 11 vota, kundër 4 vota, abstenim 0 vota konstatoi se miratimi i buxheti për vitin 2023 u miratua.

Mbledhja e shpall e mbyllur në ora 10:35

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha



Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi

